



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuesi/Personi nën hetim **Arben Domi**, më datën **25.06.2024**, Nr. Regj. Them. **391**, ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: **1.** Verifikimi i nevojave të sigurimit për personin nën hetim **Arben Domi**; **2.** Revokimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi” e caktuar për personin nën hetim **Arben Domi**, me vendimin me nr.37, datë 10.04.2024, verifikuar me vendimin nr.39, datë 14.04.2024 Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ose **3.** Zëvendësimin e saj me një masë më të lehtë.
2. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarja Flora Hajredinaj, mbështetur në nenin 228 e vijues, neni 246/6, 260 të Kodit të Procedurës Penale, me vendimin Nr. **391**, datë 04.07.2024 vendosi:
 1. Shqyrtimin në seancë gjyqësore të informacionit me shkrim të regjistruar me nr.391, datë 25.06.2024, për të arrestuarin në shtëpi **Arben Domi**.
 2. Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit “arrest në shtëpi” të caktuar ndaj shtetasit **Arben Domi** me vendimin nr.37, datë 10.04.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
 3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 5 (pesë) ditëve, në Gjykatën e Posaçme të Apelit, për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit arsyetuar.

Tiranë, më datë 04.07.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar